



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal - Ministarstvo za Regionalni Razvoj - Ministry of Regional Development

ANALIZA E INVESIMEVE KAPITALE SIPAS RAJONEVE ZHVILLIMORE NË KOSOVË PËR VITIN 2023

Dokumenti u hartua nga:

Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale - DPAR



Punuar nga:

Shyhrete Kastrati, Drejtoreshë e Departamentit për Performancë dhe Analiza Rajonale

Qefsere Bajrami, Udhëheqëse e Divizionit për Analiza Socio-Ekonomike Rajonale

Blinda Bytyçi, Zyrtare për Zhvillim Rajonal të Balancuar

Konsultuar nga:

Besim Kamberaj, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal

Ky publikim është përmbledhje e të dhënave të mbledhura nga Ministritë dhe komunat lidhur me investimet kapitale për vitin 2023 dhe i njëjti duhet të shërbej për nevojat e vet këtij institucioni, si dhe institucioneve tjera në nivel qendror dhe nivel lokal të Republikës së Kosovës.

Copyright. 2024 – Ministria e Zhvillimit Rajonal

Republika e Kosovës, 10 000 Prishtinë

Kati: III Ndërtesa ish Rilindja, Prishtinë

Tel: +383(0)38 200 64 526

<https://mzhr.rks-gov.net/>

PËRMBAJTJA:

| | |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| HYRJE | 7 |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 9 |
| METODOLOGJIA | 10 |
| LISTA E SHKURTESAVE | 11 |
| PËRKUFIZIME | 12 |
| KAPITULLI I | 14 |
| <u>I. INVESTIMET KAPITALE NGA NIVELI QENDROR</u> | 14 |
| I.1 Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2023 nga ministrinë dhe institucionet tjera të nivelit qendror në shtatë (7) rajone zhvillimore | 14 |
| I.2 Ministrinë dhe vlera e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2023 | 16 |
| I.3 Agjencinë dhe Institucionet tjera dhe vlera e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2023 | 18 |
| I.4 Donatorët dhe burimet tjera të financimit për investimet kapitale të realizuara gjatë vitit 2023 | 20 |
| I.5 Sektorët më të financuar nga niveli qendror v.2023 | 21 |
| I.6 Investimet nga niveli qendror të definuara dhe të pa definuara në rajone zhvillimore (komuna) | 23 |
| I.6.1 Komunat më të financuara nga niveli qendror për vitin v.2023 | 28 |
| KAPITULLI II | 29 |
| II. INVESTIMET KAPITALE NGA NIVELI QENDROR - SHPËRNDARJA RAJONALE | 29 |
| II.1 Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore | |
| II.2 Ministria e Ekonomisë dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore | 35 |
| II. 3 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë(7) Rajoneve Zhvillimore | 41 |

| | |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| II.4 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore | 47 |
| II. 5 Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore..... | 53 |
| II. 6 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore..... | 59 |
| II. 7 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore | 65 |
| II. 8 Ministria e Punëve të Brendshme dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore | 67 |
| II. 9 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore | 73 |
| II. 10 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore..... | 84 |
| II. 11 Ministria e Drejtësisë dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore..... | 94 |
| II. 12 Ministria e Shëndetësisë dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore..... | 101 |
| II.13 Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore..... | 108 |
| II. 14 Ministria e Mbrojtjes dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore..... | 113 |
| II.15 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) Rajoneve Zhvillimore..... | 116 |
| KAPITULLI III..... | 131 |
| III. INVESTIMET KAPITALE NGA NIVELI LOKAL | 131 |
| III.2 Sektorët më të financuara nga niveli lokal (komunat) për vitin 2023..... | 135 |
| III.3 Investimet nga niveli lokal (komunat) sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore | 137 |
| III.4 INVESTIMET PËR KOKË BANORI NGA NIVELI LOKAL PËR V.2023..... | 191 |

| | |
|-------------------------------------|------------|
| PËRFUNDIME..... | 194 |
| REKOMANDIME | 196 |
| BURIMET E INFORMACIONIT..... | 197 |

HYRJE

Investimet kapitale luajnë një rol kyç në zhvillimin ekonomik, social dhe infrastrukturor të rajoneve zhvillimore, duke shërbyer si bazë për përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme dhe nxitjen e rritjes së qëndrueshme. Nëpërmjet tyre, realizohen projekte që sjellin përfitime afatgjata dhe që ndikojnë në çdo aspekt të jetës së qytetarëve. Rëndësia e investimeve kapitale mund të përmblihet në disa aspekte kryesore që ndikojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe infrastrukturor të rajoneve zhvillimore, si:

- Zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës, ku investimet kapitale kontribuojnë në rritjen ekonomike, mundësojnë zhvillimin e infrastrukturës dhe objekteve publike, duke krijuar një mjedis të favorshëm për bizneset dhe investimet private.
- Përmirësimi i infrastrukturës publike, mundëson përmirësimin e transportit, energjisë dhe shërbimeve të tjera publike të cilat ndihmojnë në lidhjen e rajoneve dhe lehtësimin e lëvizjes së mallrave dhe njerëzve, si dhe rritjen e çasjes në shërbime bazë për komunitetin, me theks në komunitat apo vendëbanimet më pak të zhvilluara.
- Reduktimi i pabarazive rajonale, i cili është një nga objektivat më të rëndësishme të investimeve kapitale në të cilën përfshihet shpërndarja e balancuar mes rajoneve të ndryshme, duke synuar reduktimin e pabarazive socio – ekonomike dhe krijimin e kushteve të barabarta për zhvillim, veçanërisht për zonat rurale ose vendëbanimet më pak të zhvilluara.
- Përmirësimi i cilësisë së jetës, ku investimet kapitale ndikojnë drejtëpërdrejtë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve përmes projekteve që mbështesin arsimin, shëndetësinë dhe aktivitetet kulturore.
- Investime në sektorë strategjikë, si teknologjia dhe industria, të cilët kontribuojnë në përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe rritjen e kapaciteteve eksportuese të vendit. Për më tepër ato mbështesin zhvillimin e inovacionit dhe përmirësimin e kapaciteteve teknologjike, duke fuqizuar ekonominë rajonale në tregun global gjithnjë e më të integruar.

Investimet kapitale janë shtyllë e domosdoshme për zhvillimin socio – ekonomik të rajoneve zhvillimore, për zhvillimin e një ekonomie të balancuar dhe të qëndrueshme, duke garantuar përfitime afatgjata për të gjitha rajonet zhvillimore.

Analiza e Investimeve Kapitale sipas Rajoneve Zhvillimore për vitin 2023, fokusohet në pasqyrimin e investimeve kapitale të Republikës së Kosovës në kontekstin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal e cila është një ndër kategoritë më të rëndësishme të shpenzimeve buxhetore. Ajo ofron një pasqyrë të shpërndarjes së investimeve dhe përdor të dhënat për vlerësimin e investimeve për kokë banori, duke mundësuar identifikimin e nivelit të investimeve në raport me popullsinë në rajone dhe komuna të ndryshme, si dhe zbardh pabarazitë rajonale në investime.

Kjo analizë, e përgatitur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), ofron një pasqyrë të plotë të planifikimit dhe realizimit të investimeve kapitale për vitin 2023. Përfshin të dhëna nga të gjitha organizatat buxhetore si nga niveli qendror ashtu edhe nga ai lokal. Analiza për herë të parë fokusohet në ndarjen dhe pasqyrimin e investimeve kapitale të Republikës së Kosovës në kontekstin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal, sipas shtatë rajoneve zhvillimore të Kosovës: Qendër, Veri, Perëndim, Jug, Juglindje, Lindje dhe Jugperëndim, brenda këtij kuadri, shqyrtohen aspektet kryesore, përfshirë:

- Kontributin e ministrive dhe komunave në financimin e projekteve kapitale sipas rajoneve.
- Sektorët kryesorë të përqëndrimit të fondeve dhe pabarazitë në shpërndarjen e tyre.
- Vlerësimin e investimeve për kokë banori, si nga niveli qendror, ashtu edhe nga niveli lokal, bazuar në regjistrimin e popullsisë për vitin 2024 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (sipas të dhenave preliminare).

Qëllimi i kësaj analize është të sigurojë një kuptim të qartë mbi mënyrën e shpërndarjes dhe efektivitetit të investimeve kapitale në tërë vendin, e cila përbënë një mjet të fuqishëm për hartimin e politikave dhe strategjive që mbështesin zhvillimin rajonal të balancuar. Ajo jo vetëm që adresonë sfidat aktuale, por gjithashtu hap rrugë të reja për përmirësim dhe zhvillim afatgjatë të rajoneve zhvillimore.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Analiza e Investimeve Kapitale për vitin 2023, e fokusuar te rajonet zhvillimore të Kosovës, paraqet një vlerësim të hollësishëm mbi shpërndarjen e investimeve nga niveli qendror dhe lokal në shtatë (7) rajonet zhvillimore: Qendër , Veri, Perëndim, Jug, Juglindje, Lindje dhe Jugperëndim. Për dallim nga viti i kaluar, në këtë dokument janë analizuar investimet në shtatë rajone zhvillimore, si dhe janë përfshirë të gjitha planifikimet dhe realizimi i shpenzimeve të të gjitha organizatave buxhetore nga të dy nivelet ai qendror dhe lokal, duke siguruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi shpërndarjen e burimeve financiare dhe ndikimin e tyre. Duke pasur parasysh mandatin dhe vizionin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal (MZHR) për të promovuar një zhvillim rajonal të balancuar, analiza ofron një përshkrim të investimeve kapitale të ndara sipas rajoneve dhe konkretizohet në nivel komunal. Ajo përfshin shpërndarjen e fondeve në çdo komunë, numrin e projekteve të realizuara si dhe të gjithë sektorët e financuar. Pra, ky dokument shfaq qartë ndryshimet mes rajoneve dhe komunave lidhur me përkrahjen nga niveli qendror dhe zbatimin e projekteve kapitale gjatë vitit 2023. Shpenzimet e përgjithshme kapitale për vitin 2023 nga niveli qendror, nga burimi i financimit 10 Buxheti, janë planifikuar të jenë gjithsej 570,788,183.09 nga të cilat janë realizuar 349,369,596.75 Euro, me 582 projekte. Investimet kapitale në shtatë rajone zhvillimore sipas nivelit lokal janë planifikuar 282,314,446.33 nga të cilat janë realizuar 205,636,763.52 me 2309 projekte të realizuara.

Analiza e investimeve kapitale synon të promovojë një zhvillim rajonal të balancuar duke adresuar dallimet ekzistuese mes rajoneve të ndryshme apo më pak të zhvilluara në aspektin socio-ekonomik. Komunitat e vogla, të cilat varen në masë të madhe nga buxheti qendror (granti qeveritar) dhe investimeve të ministrive, si dhe përballen me sfida të shumta. Mos përfshirja e tyre në skemat e investimeve kapitale ndikon negativisht në mirëqenien e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik lokal. Klasifikimi institucional i buxhetit ofron një pasqyrim të detajuar mbi planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve të të gjitha organizatave buxhetore si: Ministritë, Komunitat, Kuvendin, Presidencën, Sistemi i Drejtësisë dhe Institucionet tjera të Pavarura. Përmes kësaj analize, MZHR synon të ofrojë një udhëzues të qartë për politikën e ardhshme zhvillimore, duke theksuar rëndësinë e shpërndarjes së drejtë dhe efektive të burimeve për përmirësimin e standardit të jetesës dhe zhvillimin e gjithanshëm socio-ekonomik.

METODOLOGJIA

Ky dokument është hartuar duke marr për bazë legjislacionin në fuqi, Raportin e Ndarjeve Buxhetore dhe Shpenzimeve të Investimeve Kapitale për vitin 2023, nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve/Departamenti i Thesarit - të dhënat nga Sistemi Informativ i menaxhimit të Financave të Kosovës-SIMFK, të cilat janë analizuar dhe krahasuar, si dhe komentet e pranuar me shkrim nga ministrat e linjes, insitucionet tjera relevante dhe komunat.

Në pjesën e parë të analizës është përfshirë çasje e përgjithshme e këndvështrimit të investimeve kapitale nga niveli qendror, duke vazhduar me pjesën e nivelit lokal, që kanë të bëjnë me planifikimin buxhetor dhe realizimin e investimeve si nga grantet qeveritare , nga të hyrat vetanake si dhe të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak.

Dokumenti është konsultuar në vazhdimësi në mënyrë elektronike me të gjitha ministratë dhe komunat në lidhje me të dhënat e kërkuara sipas rajoneve zhvillimore në mënyrë që të kemi një saktësi në të dhëna dhe të gjeturat të prezantohen në mënyrë sa më profesionale. Janë realizuar takime të drejtëpërdrejta me institucione për të sqaruar paqartësitë, është organizuar Konferenca "Prezantimi dhe Promovimi i Dokumenteve Analitike për Zhvillim Socio- Ekonomik Rajonal të Balancuar". Gjatë kësaj konference është prezantuar ky dokument dhe është i dhënë mundësia të gjitha insitucionet të kontribuojnë pas shqyrtimit të rezultateve të përpunuara.

LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|----------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| MZHR | Ministria e Zhvillimit Rajonal |
| MFPT | Ministria e Financave, Punës dhe Transferve |
| LMFPP | Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi |
| LFPL | Ligji Nr. 03/L-049 për Financa të Pushtetit Lokal |
| RNBShik | Raporti i Ndarjeve Buxhetore dhe Shpenzimeve të Investimeve Kapitale për vitin 2023 |
| SIMFK | Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës |
| OB | Organizata Buxhetore |
| KASH | Korniza afatmesme e shpenzimeve |
| AZHR | Agjensionet për Zhvillim Rajonal |
| ASK | Agjensioni i Statistikave të Kosovës |
| ML | Ministritë e Linjës |
| RZHQ | Rajoni Zhvillimor Qendër |
| RZHV | Rajoni Zhvillimor Veri |
| RZHP | Rajoni Zhvillimor Perëndim |
| RZHJ | Rajoni Zhvillimor Jug |
| RZHJL | Rajoni Zhvillimor Juglindje |
| RZHL | Rajoni Zhvillimor Lindje |
| RZHJP | Rajoni Zhvillimor Jugperëndim |

PËRKUFIZIME

Rajon zhvillimor« - nënkupton territorin funksional që përfshinë dy apo më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me kriteret e NUTS-3, për zbatimin e politikave të zhvillimit rajonal, i cili dallohet nga një tërësi karakteristikash gjeografike, socio-ekonomike, kulturore, mjedisore. Rajoni zhvillimor përfshinë zhvillimin socio-ekonomik rajonal të balancuar, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në asnjë rrethanë nuk nënkupton organizim administrativ apo territorial.

Zhvillimi rajonal « është një përpjekje e përgjithshme për të reduktuar pabarazitë rajonale, duke mbështetur (punësimin dhe gjenerimin e pasurisë/mirëqenies) aktivitete ekonomike në rajone;

Pabarazi rajonale « nënkupton gjendjen kur evidentohen dallime substanciale në mes të rajoneve zhvillimore sipas indikatorëve socio-ekonomik.

Zhvillimi i balancuar rajonal « nënkupton procesin e uljes së dallimeve në aspekt të zhvillimit socio-ekonomik si dhe përafrimi i nivelit të zhvillimit ekonomik, social, kulturor e mjedisor, ndërmjet rajoneve të ndryshme zhvillimore përmes shfrytëzimit të potencialeve të tyre sa i përket resurseve financiare, natyrore dhe kapitalit njerëzor.

Politikat për zhvillim rajonal « - nënkuptojnë kornizën e dokumenteve strategjike dhe planifikuese të zhvillimit rajonal me qëllim të intervenimeve në fusha të caktuara të cilat do të zbatohen për arritjen e synimit të zhvillimit të balancuar rajonal. Varësisht nga ndryshimet dhe avancimi i dokumenteve strategjike, objektivat e zhvillimit rajonal, do t'i referohen dhe adaptohen ndryshimeve të fundit.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim « është një dokument i cili ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës dhe përfaqëson një dokument nismash zhvillimore të cilat janë objektiva kombëtare që kanë konsensus të gjerë shoqëror;

Projekt Kapital « –një investim afatgjatë që përdoret për të ndërtuar, rritur ose përmirësuar asetet, sipas kriterëve të përcaktuara, ashtu siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale.

Rajonet zhvillimore sipas fushëveprimtarisë së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal:

01 - Rajoni Zhvillimor Qendër

02 - Rajoni Zhvillimor Veri

03 - Rajoni Zhvillimor Perëndim

04 - Rajoni Zhvillimor Jug

05 - Rajoni Zhvillimor Juglindje

06 - Rajoni Zhvillimor Lindje

07 - Rajoni Zhvillimor Jugperëndim

KAPITULLI I

INVESTIMET KAPITALE NGA NIVELI QENDROR

I.1 Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2023 nga Ministritë dhe Institucionet tjera të nivelit qendror në shtatë (7) Rajone Zhvillimore

Për përgatitjen e Analizës e Investimeve Kapitale për vitin 2023 janë trajtuar investimet kapitale nga niveli qendror në nivel lokal, duke përfshirë ministritë dhe institucionet tjera të nivelit qendror që realizojnë investime kapitale sipas mandatit të tyre dhe programeve që implementojnë.

Kjo analizë reflekton investimet e nivelit qendror, të ndara sipas komunave, sektorëve dhe rajoneve, duke krahasuar gjithashtu ndikimin e tyre në zhvillimin socio-ekonomik të balancuar ndërmjet shtatë (7) rajoneve zhvillimore me të cilat operon Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR). Analiza përfshinë të dhëna duke u bazuar në planifikimin dhe shpenzimet e realizuara për investime kapitale, së bashku me numrin e projekteve të financuara, të paraqitura në bazë të vlerave financiare për vitin 2023, të realizuara nga ministritë, agjencitë dhe institucionet tjera të nivelit qendror.

Detajet e këtyre investimeve janë të shprehura në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2023 nga Niveli Qendror sipas burimit të financimit

| Niveli Qendror - Investimet Kapitale v.2023 | | |
|---------------------------------------------|-----------------------------|--------------------------|
| Burimi I financimit | Buxheti/ Planifikuar v.2023 | Buxheti/Shpenzuar v.2023 |
| 04 FINANCIMET NGA HUAMARRJET | 26,077,709.00 | 2,531,692.62 |
| 06 FINANC.HUAMARR.PER.KLAUZ.INVEST. | 104,877,903.00 | 17,519,356.00 |
| 10 BUXHETI | 436,944,494.58 | 327,956,251.17 |
| 23 TË HYRAT E DEDIKUARA | 789,237.00 | 789,237.00 |
| 31 GRANT I DONAT.TË MBRENDSHËM | 66,023.74 | - |
| 32 GRANTE TJERA TE JASHTME | 515,899.20 | 129,150.00 |

| | | |
|------------------------------------|-----------------------|-----------------------|
| 34 PROCREDIT BANK | 112.32 | - |
| 41 WB-BANKA BOTËRORE | 81,349.58 | 2,386.80 |
| 44 QEVERIA BRITANEZE | 0.31 | - |
| 49 EU-UNIONI EUROPIAN | 497,493.51 | 221,856.00 |
| 54 QEVERIA ITALIANE | 315,385.79 | - |
| 57 QEVERIA NORVEGJEZE | 146,965.47 | 146,965.47 |
| 59 QEVERIA JAPONEZE | 180,776.00 | - |
| 61 QEVERIA ZVICRANE | 1,076.68 | - |
| 70 GIZ | 28,150.00 | - |
| 73 USAID | 88,402.10 | 2,900.00 |
| 81 GLOBAL FUND | 15.12 | - |
| 84 QEVERIA E SHQIPERISE | 2.00 | - |
| 8A NOVARTIS PHARMA SERVICES | 4,093.00 | - |
| 8D DONACION I PASPECIFIKUAR | 103,282.00 | - |
| 93 COUNCIL OF EUROPE | 69,801.69 | 69,801.69 |
| 96 TEMPUS | 11.00 | - |
| Totali I Përgjithshëm | 570,788,183.09 | 349,369,596.75 |

Tabela 2. Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2023 nga Niveli Qendror

| INVESTIMET KAPITALE | Buxheti/ Planifikuar v.2023 | Buxheti/Shpenzuar v.2023 |
|------------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------|
| MINISTRITË | € 415,700,892.58 | € 310,324,336.87 |
| INSTITUCIONET TJERA NIVEL QENDROR | € 21,243,602.00 | € 17,631,914.30 |
| KATEGORITË TJERA | € 133,843,688.51 | € 21,413,345.58 |
| GJITHSEJ | € 570,788,183.09 | € 349,369,596.75 |

I.2 Ministritë dhe vlera e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2023

Në këtë kapitull janë paraqitur investimet e përgjithshme kapitale nga niveli qendror, vlerat financiare të investuar dhe numri i përgjithshëm i projekteve të realizuara nga Ministritë, bazuar në sektorët të cilët MZHR harton analizën vjetore me ndikim socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Investimet kapitale janë të pasqyruara në total në tabelat në vijim. Referuar tabelës nr.3 të investimeve kapitale mund të shihet se investimet kapitale për vitin 2023 në total kanë arritur vlerën 310,324,336.87 Euro, nga vlera e planifikuar prej 415,700,892.58 Euro, të realizuar nga të gjitha ministritë apo 75% të buxhetit të realizuar.


Ministria që ka realizuar më shumë investime kapitale gjatë vitit 2023 ka qenë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e cila ka realizuar projekte kapitale me një vlerë totale prej 120,723,494.17 €, që përbën 78% të buxhetit të realizuar. Pas saj renditet Ministria e Mbrojtjes, me një vlerë të realizuar prej 89,032,284.45 €, nga një buxhet i planifikuar prej 112,799,386.67 €, që është 79% e realizimit të buxhetit. Po ashtu, Ministria e Punëve të Brendshme ka realizuar një buxhet prej 40,979,522.31 €, nga një vlerë e planifikuar prej 53,935,564.81 €, që është 76% e buxhetit të realizuar. Ministria e Zhvillimit Rajonal ka realizuar 2,169,365.81 €, nga një vlerë e planifikuar prej 2,500,000.00 €, që përbën 87% të buxhetit të realizuar, ndërsa Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka realizuar 15,761,465.97 € nga 21,218,230.57 €, që është 74% e buxhetit të saj, ndërsa Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar 12,999,724.57 €, nga 24,254,865.70 €, që përbën 54% të buxhetit të realizuar. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka realizuar 11,760,746.22 €, nga 12,705,000.00 € të planifikuara, që është 90% e realizimit të buxhetit. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka realizuar 4,331,759.25 €, nga një vlerë e planifikuar prej 13,531,760.00 €, që është 32% e buxhetit të realizuar. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka realizuar 3,610,586.63 €, nga një buxhet i planifikuar prej 5,300,000.00 €, që përbën 68% të realizimit të buxhetit të saj. Ministria e Shëndetësisë ka realizuar 2,898,112.46 €, nga një vlerë e planifikuar prej 4,919,512.00 €, që është 59% e buxhetit të realizuar. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka realizuar 2,525,677.97 €, nga 3,586,977.00 € të planifikuara, që është 70% e buxhetit të realizuar. Më në fund, Ministria për

Komunitete dhe Kthim ka realizuar 1,147,880.25 €, nga një buxhet i planifikuar prej 2,738,420.00 €, që është 42% e realizimit të buxhetit të saj.

Tabela 3. Investimet kapitale nga Ministrinë për vitin 2023

| NIVELI QENDROR - INVESTIMET KAPITALE 2023 | | | | |
|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|--------------------------|-----------------------|
| 10 BUXHETI | | | | |
| N r. | Institucioni | Buxheti Aktual/ Planifikuar | Aktuali/Shpenzuar | % e realizimit |
| 1 | 201 MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE | 13,531,760.00 | 4,331,759.25 | 32% |
| 2 | 203 MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL | 1,750,505.00 | 1,114,906.49 | 64% |
| 3 | 204 MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË | 3,586,977.00 | 2,525,677.97 | 70% |
| 4 | 205 MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKT | 154,012,621.83 | 120,723,494.17 | 78% |
| 5 | 206 MINISTRIA E SHËNDETËSISË | 4,919,512.00 | 2,898,112.46 | 59% |
| 6 | 207 MINISTRIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT | 24,254,865.70 | 12,999,724.57 | 54% |
| 7 | 208 MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT | 21,218,230.57 | 15,761,465.97 | 74% |
| 8 | 211 MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM | 2,738,420.00 | 1,147,880.25 | 42% |
| 9 | 212 MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL | 5,300,000.00 | 3,610,586.63 | 68% |
| 10 | 213 MINISTRIA E EKONOMISË | 1,092,299.00 | 579,073.28 | 53% |
| 11 | 214 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME | 53,935,564.81 | 40,979,522.31 | 76% |
| 12 | 215 MINISTRIA E DREJTËSISË | 1,355,750.00 | 689,737.04 | 51% |
| 13 | 216 MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORA | 12,705,000.00 | 11,760,746.22 | 93% |
| 14 | 217 MINISTRIA E MBROJTJES | 112,799,386.67 | 89,032,284.45 | 79% |
| 15 | 221 MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL | 2,500,000.00 | 2,169,365.81 | 87% |
| | Gjithsej | 415,700,892.58 | 310,324,336.87 | 75% |

Figura 1. Investimet kapitale në përqindje (%) nga Ministrinë për vitin 2023



I.3 Agjencitë dhe institucionet tjera dhe vlera e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2023

Investimet kapitale nga niveli qendror, përfshirë investimet kapitale të institucioneve të tjera si Kuvendi, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Agjencitë dhe Institucionet e tjera të nivelit qendror, janë pasqyruar përmes planifikimit, shpenzimit dhe sektorëve që mbështesin këto institucione.

Vlera e planifikuar e investimeve kapitale nga këto institucione përfshinë 21,243,602.00 €, ndërsa vlera e realizuar e investimeve kapitale ka arritur 17,631,914.30 €, që përbën 83% të buxhetit të realizuar për vitin 2023. Sektorët në të cilët janë realizuar këto investime përfshijnë: *pajisje IT, sisteme digjitale, automjete, ndërtimi dhe dizajnimi i objekteve, pajisje mjekësore, infrastruktura e objekteve, etj.* Në formë tabelare, pasqyrohen investimet kapitale të realizuara nga secili institucion.

Tabela 4. Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2023 nga Niveli Qendror Agjencitë dhe Institucionet tjera

| NIVELI QENDROR INVESTIMET KAPITALE V. 2023 | | | | | |
|--------------------------------------------|--------------------------------------------------|--------------------------------|------------------------|----------------|-----------------------------------------------------------------------------------|
| 10 BUXHETI | | | | | |
| Nr. | Institucioni | Buxheti Aktual/ Planifikuar | Aktuali/Shpenzuar | % e realizimit | Sektori |
| 1 | 101 KUVENDI | € 244,863.00 | € 162,189.93 | 66% | Sisteme digjitale, paisje ngrohje, kamera |
| 2 | 102 ZYRA E PRESIDENTIT | € 59,705.00 | € 59,326.83 | 99% | Paisje IT |
| 3 | 104 ZYRA E KRYEMINISTRIT | € 221,000.00 | € 190,748.96 | 86% | Paisje IT |
| 4 | 230 KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT | € 75,000.00 | € - | 0 | |
| 5 | 235 AUTORITETI RREGULLATOR I KOMUNIKIMIT | € 160,000.00 | € 66,029.47 | 41% | Sisteme, paisje |
| 6 | 236 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT | € 20,000.00 | € 6,677.00 | 33% | Sisteme digjitale, paisje teknologjike |
| 7 | 238 ZYRA E RREGULLATORIT TË ENERGIJË | € 72,000.00 | € 70,812.00 | 98% | Paisje IT |
| 8 | 239 AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT | € 15,700.00 | € 12,700.00 | 81% | Paisje IT, Paisje tjera |
| 9 | 242 UNIVERSITETI I PRISHTINËS | € 5,400,000.00 | € 5,327,468.36 | 99% | Fakulteteve, Paisje, |
| 10 | 243 GJYKATA KUSHTETUESE | € 61,338.00 | € 56,544.40 | 92% | Paisje IT, Softwer |
| 11 | 247 PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PAISJE | € 9,000.00 | € 4,376.00 | 49% | Sisteme digjitale |
| 12 | 254 AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NA VIGANCIA | € 1,732,550.00 | € 1,402,218.07 | 81% | Paisje te IT, Paisje tjera, infrastrukturë |
| 13 | 302 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT | € 74,000.00 | € 36,890.39 | 50% | Zhvillim infrastrukturës se IT |
| 14 | 318 KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE ENERGI | € 19,500.00 | € 17,000.00 | 87% | Softwer |
| 15 | 319 KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA | € 50,000.00 | € - | 0% | |
| 16 | 328 KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS | € 1,955,000.00 | € 1,305,320.00 | 67% | Automjete, Ndertimi dhe dizjanimi I objekteve |
| 17 | 329 AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIMIN E KALIBERIT | € 97,500.00 | € 36,780.00 | 38% | Vetura |
| 18 | 250 KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS | € 697,795.00 | € 225,795.44 | 32% | Paisje hardwerike softwerike, digjitalizim sisteme, renovim objekti, paisje tjera |
| 19 | 322 AKADEMLIA E DREJTËSISË | € 196,000.00 | € 95,815.00 | 49% | Paisje te IT, Vetura |
| 20 | 245 AGJENCIA E KOSOVËS PËR INTELEGJENCIA | € 2,159,076.00 | € 1,315,885.83 | 61% | Projekte te Pa specifikuar |
| 21 | 220 SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERSITETI | € 7,923,575.00 | € 7,239,336.62 | 91% | Paisje mjekësore, infrastrukturë te objekteve |
| | Gjithsej | € 21,243,602.00 | € 17,631,914.30 | 83% | |

I.4 Donatorët dhe burimet tjera të finanimit për investimet kapitale të realizuara gjatë vitit 2023

Tabela 5. Investimet e përgjithshme kapitale për vitin 2023 nga Niveli Qendror – Donatorë


| NIVELI QENDROR, INVESTIMET KAPITALE V.2023 | | | |
|---------------------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------|--------------------------|
| Nr. | Përshkrimi | Buxheti Aktual/ Planifikuar | Aktuali/Shpenzuar |
| 1 | 04 FINANCIMET NGA HUAMARRJET | 26,077,709.00 | 2,531,692.62 |
| 2 | 06 FINANC.HUAMARR.PER.KLAUZ.INVEST. | 104,877,903.00 | 17,519,356.00 |
| 3 | 23 TË HYRAT E DEDIKUARA | 789,237.00 | 789,237.00 |
| 4 | 31 GRANT I DONAT.TË MBRENDSHËM | 66,023.74 | - |
| 5 | 32 GRANTE TJERA TE JASHTME | 515,899.20 | 129,150.00 |
| 6 | 34 PROCREDIT BANK | 112.32 | - |
| 7 | 41 WB-BANKA BOTËRORE | 81,349.58 | 2,386.80 |
| 8 | 44 QEVERIA BRITANEZE | 0.31 | - |
| 9 | 49 EU-UNIONI EUROPIAN | 497,493.51 | 221,856.00 |
| 10 | 54 QEVERIA ITALIANE | 315,385.79 | - |
| 11 | 57 QEVERIA NORVEGJEZE | 146,965.47 | 146,965.47 |
| 12 | 59 QEVERIA JAPONEZE | 180,776.00 | - |
| 13 | 61 QEVERIA ZVICRANE | 1,076.68 | - |
| 14 | 70 GIZ | 28,150.00 | - |
| 15 | 73 USAID | 88,402.10 | 2,900.00 |
| 16 | 81 GLOBAL FUND | 15.12 | - |
| 17 | 84 QEVERIA E SHQIPERISE | 2.00 | - |
| 18 | 8A NOVARTIS PHARMA SERVICES | 4,093.00 | - |
| 19 | 8D DONACION I PASPECIFIKUAR | 103,282.00 | - |
| 20 | 93 COUNCIL OF EUROPE | 69,801.69 | 69,801.69 |
| 21 | 96 TEMPUS | 11.00 | - |
| | GJITHSEJ | 133,843,688.51 | 21,413,345.58 |

I.5 Sektorët më të financuar nga Niveli Qendror v.2023

Tabela 6. Sektorët më të financuar nga niveli qendror

| Sektorët më të financuar nga Niveli Qendror | Vlera financiare |
|------------------------------------------------|-------------------------|
| Sisteme, pajisje për mbrojtje, mjete informimi | € 74,136,791.44 |
| Shpronësimet | € 43,661,605.75 |
| Konfidenciale | € 33,721,660.86 |
| Ndërtesa administrative | € 31,644,273.22 |
| Rrugë lokale | € 30,317,163.58 |
| Rruge Nacionale | € 16,812,579.46 |
| Autoudhë | € 12,711,111.83 |
| Rrugë Rajonale | € 12,211,412.78 |
| Objekte arsimore | € 11,158,470.01 |
| Automjete | € 9,387,519.01 |
| Pajisje tjera | € 8,513,331.82 |
| Objektet kulturore | € 5,785,712.39 |
| Pajisje mjekësore | € 4,951,726.17 |
| Objekte sportive | € 4,062,618.41 |
| Kapital tjetër | € 4,202,500.27 |
| Mirëmbajtje e Inves.e rrugëve dhe e objektit | € 3,887,262.65 |
| Rregullimi i lumenjëve | € 2,694,095.49 |
| Memoriale | € 2,640,820.84 |
| Pajisje/IT | € 2,544,001.22 |
| Sisteme/Softwerike | € 2,461,228.46 |
| Objekte banimi | € 1,607,322.45 |
| Zona ekonomike | € 1,457,308.90 |
| Pajisje të tjera laboratorike(dhe laborator) | € 2,152,943.55 |
| Deponi mbeturina | € 1,180,614.52 |
| Objekte shëndetësore | € 828,705.92 |
| Sistem i ujitjes | € 808,390.67 |
| Kanalizim | € 617,275.28 |
| Parqe/hapësira gjelbëruese | € 438,474.67 |
| Ujësjiellës | € 344,518.96 |
| Pyjëzim | € 286,371.82 |
| Turizëm | € 247,807.39 |
| Park teknologjik dhe inkubator biznesi | € 203,800.10 |
| Efiçencë | € 118,862.83 |
| Parqe nacionale | € 104,016.00 |
| Depo | € 53,952.45 |
| Të tjera nga Hua. dhe Donatorë | € 21,413,345.58 |
| Gjithsej | € 349,369,596.75 |

Figura 2. Sektorët e financuar investime kapitale nga Niveli Qendror për v.2023



I.6 Investimet nga Niveli Qendror të definuara dhe të pa definuara në rajone zhvillimore (komuna)

Bazuar në investimet totale të nivelit qendror vlera e të cilave është 349,369,596.75 Euro, ne kemi arritur të pasqyrojmë shpërndarjen e saj në rajone dhe komuna vlerën financiare prej 103,287,385.44 €. Kjo vlerë është pasqyruar e shpërndarë në shtatë (7) rajone zhvillimore përfshirë komunat përbërëse të secilit rajon.

Në tabelën vijuese janë pasqyruar edhe investimet për kokë banori bazuar në vlerat e projekteve të definuara në rajone (komuna) dhe projekteve të pa definuara për vitin 2023.

Sqarim: Bazuar në të dhënat e pranuar nga akterët bashkëpunues të nivelit Qendror në hartimin e këtij dokumenti, investimet kapitale janë pasqyruar në dy kategori:

- të definuara: (projektet të cilat janë të pasyruara në komunën të cilën është realizuar projekti);
- të pa definuara: (projektet të cilat nuk janë të pasyruara në komunën të cilën është realizuar projekti);

Tabela 7. Investimet kapitale të definuara për rajonet dhe komuna v.2023

| Rajonet Zhvillimore | Popullsia e Kosovës - Regjistrimi 2024 (të dhënat preliminare) | Shpërndaja e investimeve të definuara në rajone zhvillimore (komuna) v.2023 | Investimet për kokë banori të definuara në rajone dhe komuna |
|---------------------|----------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|
| Rajoni Qendër | 507,443 | € 43,643,183.44 | 86.01 |
| Rajoni Veri | 173,551 | € 8,163,808.67 | 47.04 |
| Rajoni Perëndim | 174,059 | € 15,464,337.70 | 88.85 |
| Rajoni Jug | 227,664 | € 6,011,760.44 | 26.41 |
| Rajoni Juglindje | 154,621 | € 12,075,912.33 | 78.10 |
| Rajoni Lindje | 180,897 | € 9,008,054.11 | 49.80 |
| Rajoni Jugperëndim | 168,424 | € 8,920,328.75 | 52.96 |
| Gjithsej | 1,586,659 | € 103,287,385.44 | 65.09 |

Figura 3. Shpërndarja e investimeve kapitale të definuara në % në rajone zhvillimore





Figura 4. Investimet kapitale për kokë banori të definuara në rajone zhvillimore (komuna) v.2023



Në tabelën me nr.8 janë pasqyruar investimet kapitale të pa definuara në rajone zhvillimore dhe komuna për v.2023, ku vlera financiare e pasqyruar në rajone është gjetur nga kalkulimi (nga totali i investimeve për kokë banori).

Tabela 8. Investimet kapitale të padefinuara në rajone dhe komuna për v.2023

| Rajonet zhvillimore | POPULLSIA E KOSOVËS - REGJISTRIMI 2024(preliminare) | Shpërndaja e investimeve te padefinuara ne rajone zhvillimore v.2023 |
|---------------------|-----------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|
| Rajoni Qendër | 507,443 | € 78,701,658.99 |
| Rajoni Veri | 173,551 | € 26,916,819.46 |
| Rajoni Perëndim | 174,059 | € 26,995,607.51 |
| Rajoni Jug | 227,664 | € 35,309,452.48 |
| Rajoni Juglindje | 154,621 | € 23,980,879.06 |
| Rajoni Lindje | 180,897 | € 28,056,144.25 |
| Rajoni Jugperëndim | 168,424 | € 26,121,649.55 |
| | Gjithsej | € 246,082,211.31 |

Figura 5. Investimet kapitale për kokë banori të projekteve të padefinuara në rajone zhvillimore (komuna)




Tabela 9. Totali i investimeve për shtatë rajonet për v.2023

| RAJONET ZHVILLIMOR E | POPULLSIA E KOSOVËS – REGJISTRIMI(PRELIMINAR) 2024 | Vlera e Investimeve Kapitale të definuara në rajone dhe komuna | Vlera e Investimeve Kapitale të shperndara pas kalkulimit të investimeve për kokë banori | Totali i Investimeve Kapitale (nga totali I investimeve të definaura dhe të padefinuara) |
|-----------------------------|------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Rajoni Qendër | 507,443 | € 43,643,183.44 | € 78,701,658.99 | € 122,344,842.43 |
| Rajoni Veri | 173,551 | € 8,163,808.67 | € 26,916,819.46 | € 35,080,628.13 |
| Rajoni Perëndim | 174,059 | € 15,464,337.70 | € 26,995,607.51 | € 42,459,945.21 |
| Rajoni Jug | 227,664 | € 6,011,760.44 | € 35,309,452.48 | € 41,321,212.92 |
| Rajoni Juglindje | 154,621 | € 12,075,912.33 | € 23,980,879.06 | € 36,056,791.39 |
| Rajoni Lindje | 180,897 | € 9,008,054.11 | € 28,056,144.25 | € 37,064,198.36 |
| Rajoni Jugperëndim | 168,424 | € 8,920,328.75 | € 26,121,649.55 | € 35,041,978.30 |
| GJITHSEJ | 1,586,659 | € 103,287,385.44 | € 246,082,211.31 | € 349,369,596.75 |

Figura 6. Shpërndarja e investimeve kapitale në rajone zhvillimore v.2023





Tabela 10. Investimet kapitale për kokë banori nga totali i investimeve kapitale për vitin v.2023

| RAJONET ZHVILLIMORE | POPULLSIA E KOSOVËS – REGJISTRIMI (PRELIMINAR) 2024 | Totali I Investimeve Kapitale per K/B nga investimet e (definuara dhe të padefinuara në rajone zhvillimore) v.2023 |
|---------------------|-----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Rajoni Qendër | 507,443 | € 241.10 |
| Rajoni Veri | 173,551 | € 202.13 |
| Rajoni Perëndim | 174,059 | € 243.94 |
| Rajoni Jug | 227,664 | € 181.50 |
| Rajoni Juglindje | 154,621 | € 233.19 |
| Rajoni Lindje | 180,897 | € 204.89 |
| Rajoni Jugperëndim | 168,424 | € 208.06 |
| GJITHSEJ | 1,586,659 | € 220.19 |

Figura 7. Investimet kapitale për kokë banori nga totali i projekteve të definuara dhe padefinuara në rajone zhvillimore (komuna)



I.6.1 Komunat më të financuara nga Niveli Qendror për vitin v.2023

Rajoni Qendër: 1. Prishtinë € 35,010,410.50; 2. Podujevë € 2,921,666.28; 3. Lipjan € 2,432,653.99; 4. Glllogoc € 1,609,072.20; 5. Fushë Kosovë € 738,627.71; 6. Graçanicë € 490,339.19; 7. Obiliq € 440,413.57;

Rajoni Veri: 1. Mitrovicë € 5,025,264.70 ; 2. Skënderaj € 1,680,499.67; 3. Vushtrri € 1,458,044.30 ;

Rajoni Perëndim: 1. Deçan € 6,314,641.42; 2. Pejë € 4,669,944.65; 3. Istog € 2,880,315.49, Klinë € 1,599,436.14;

Rajoni Jug: 1. Suharekë € 3,641,893.93; 2. Prizren € 1,414,502.10; Dragash € 643,101.83; Mamushë € 312,262.58;

Rajoni Juglindje: 1. Ferizaj € 8,939,882.48; 2. Shtime € 2,529,302.32; 3. Kaçanik € 256,317.99; 4. Hani I Elezit € 251,722.54; 5. Shtërpcë € 98,687.00

Rajoni Lindje: 1. Gjilan € 3,622,595.50; 2. Kamenicë € 2,601,728.41; 3. Viti € 2,245,676.85; 4. Novobërdë € 295,471.84 ; 5. Klllokot € 111,926.06 ; 6. Partesh € 70,000.00; 8. Ranillug € 60,655.45

Rajoni Jugperëndim: 1. Gjakovë € 3,900,999.92; 2. Malishevë € 2,213,023.51; 3. Rahovec € 1,894,747.29 4; Junik € 911,558.03.

Vlerat financiare janë vlerat nga totali i investimeve kapitale të pasyruara në komuna të rajoneve zhvillimore.

KAPITULLI II

II. INVESTIMET KAPITALE NGA NIVELI QENDROR- SHPËRNDARJA RAJONALE

II. 1 Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe shpërndarja e balancuar e investimeve kapitale për vitin (2023) sipas shtatë (7) rajoneve zhvillimore

Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) ka realizuar një buxhet prej 2,169,365.81 eurosh për investime kapitale gjatë vitit 2023, duke mbuluar shtatë rajone zhvillimore. Kjo përfaqëson 87% të vlerës totale të planifikuar prej 2,500,000.00 eurosh. Investimet janë shpërndarë në shtatë sektorë kryesorë, duke përfshirë: *ndërtesa administrative objekte kulturore, objekte turistike rrugë lokale, kanalizim, parqe dhe rregullim lumenjëve*. Sektori me përfitimin më të madh është infrastruktura e rrugëve lokale, me një shumë totale prej 587,003.83 eurosh të investuara. Sektorët e tjerë dhe vlerat përkatëse të investimeve janë pasqyruar në tabelat e mëposhtme.

Shpërndarja e balancuar e investimeve për v.2023

MZHR ka një shpërndarje të mirë balancuar të investimeve kapitale në shtatë (7) rajone zhvillimore duke u bazuar edhe në mandatin e saj për të ulur pabarazitë rajonale. Në rajonin Qendër janë implementuar 31%, të projekteve, pasuar me rajonin Veri me 19%, rajonin Lindje me 15% të projekteve, rajonin Jug 13% , në rajonin Juglindje dhe Jugperëndim me nga 9% secili, dhe rajoni Perëndim me 4%.

Tabela 11. Totali i investimeve dhe i projekteve të financuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në shtatë(7)rajone zhvillimore v.2023

| MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL | | | | | | | |
|--------------------------------|-------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------------------|------------------------------------|--------------------------|--------------------------|-----------------------|
| INVESTIMET KAPITALE (2023) | | | | | | | |
| Rajonet Zhvillimore (7) | Nr. I projekt eve të planifi kuara (2023) | Numri i projekteve të realizuara (2023) | Nr. i Komunave përfituese (2023) | Buxheti Aktual/ Planifikuar v.2023 | Aktuali/Shpenzuar v.2023 | Përqindja e realizimit % | Komunat jo përfituese |
| Gjithsej | 19 | 18 | 17 | € 2,500,000.00 | € 2,169,365.81 | 87% | 21 |

Tabela 12. Sektorët e financuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal v.2023

| INVESTIMET KAPITALE NIVELI QENDROR (2023) | | | | | | |
|-------------------------------------------|--------------------|-----------------|---------------------------|--------------|--------------|------------------------|
| Sektorët e investuar (2023) | | | | | | |
| Ndërtesa administrative | Objektet kulturore | Objekt turistik | Ndërtimi i rrugëve lokale | Kanalizim | Parqe | Rregullimi i lumenjëve |
| € 571,037.63 | € 184,940.96 | € 82,807.39 | € 587,003.83 | € 120,000.00 | € 285,000.00 | € 338,576.00 |

Figura 8. Sektorët e financuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për vitin 2023





Tabela 13. Projektet e financuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në shtatë (7) rajone zhvillimore për vitin 2023

| MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL | | | | | | | | | | | |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|---------------------------------|--------------------------|-----------------------------|--------------------|-----------------|--------------|-------------------|-------------------|----------------------------|-------------------------------------------------|
| INVESTIMET KAPITALE (2023) | | | | | | | | | | | |
| Rajonet Zhvillimore | Nr. I projekteve të realizuar v. (2023) | Nr. i Komunave përfitues (2023) | Aktuali/Shpenzuar v.2023 | Sektorët e investuar (2023) | | | | | | Komunat jo-përfituese 2023 | |
| | | | | Ndërtesa administrative | Objektet kulturore | Objekt turistik | Rrugë lokale | Kanalizim | Parqe | | Rregullimi i lumenjëve |
| 1. Rajoni Zhvillimor Qendër: <i>1. Prishtinë 2. Podujevë 3. Lipjan 4. Obiliq 5. Glllogoc 6. Fushë Kosovë 7. Graçanicë</i> | 1 | Podujevë | € 269,999.79 | 269,999.79 | | | | | | | <i>Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë.</i> |
| | 2 | Glllogoc | € 165,000.00 | | | | | 165,000.00 | | | |
| | 3 | Graçanicë | € 109,712.13 | | 109,712.13 | | | | | | |
| | 4 | Lipjan | € 120,000.00 | | | | | 120,000.00 | | | |
| <i>Gjithsej</i> | 4 | 4 | € 664,711.92 | 269,999.79 | 109,712.13 | | | 120,000.00 | 165,000.00 | | 3 |

| | | | | | | | | | | | |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|-----------|---------------------|--|------------------|-------------------|--|--|-------------------|--|---------------------------------------------------------------------------------------|
| | | | | | | | | | | | |
| 2. Rajoni Zhvillimor Veri: <i>1. Mitrovicë 2. Mitrovicë e Veriut 3. Leposaviç 4. Zveçan 5. ZubinPotok 6.Vushtrri 7. Skenderaj</i> | 1 | Mitrovicë | € 82,807.39 | | | 82,807.39 | | | | | |
| | 2 | Skënderaj | € 338,576.00 | | | | | | 38,576.00 | | <i>Mitrovicë e Veriut, Leposaviç; Zveçan; Zubin Potok; Vushtrri .</i> |
| Gjithsej | 2 | 2 | € 421,383.39 | | | 82,807.39 | | | 338,576.00 | | 5 |
| 3. Rajoni Zhvillimor Perëndim: <i>1. Pejë 2. Klinë 3. Istog 4.Deçan</i> | 1 | Deçan | € 75,228.83 | | 75,228.83 | | | | | | <i>Pejë, Klinë, Istog.</i> |
| | 1 | 1 | € 75,228.83 | | 75,228.83 | | | | | | 3 |
| 4. Rajoni Zhvillimor Jug: <i>1. Prizren 2. Suharekë 3. Dragash 4.Mamushë</i> | 1 | Suharekë | € 92,080.27 | | | 92,080.27 | | | | | <i>Prizren</i> |
| | 2 | Dragash | € 60,000.00 | | | 60,000.00 | | | | | |
| | 3 | Mamushë | € 140,000.00 | | | 140,000.00 | | | | | |
| Gjithsej | 3 | 3 | € 292,080.27 | | | 292,080.27 | | | | | 2 |

| | | | | | | | | | | | |
